

Grupet e shënjuara

- Mësuesit nëpër shkolla me romë dhe fëmijë emigrantë, asistentët romë të shkollave;
- Vullnetarë (studentë);
- Aktorët: politikëbërës në sferën e arsimit, përfaqësues të autoriteteve vendore, organizata vullnetare, drejtorët e shkollave në nivele të ndryshme, akademikë dhe hulumtues të fushës, etj.;
- Fëmijë emigrantë dhe romë dhe prindërit e tyre.



Inclusion of Roma and Migrants in Schools
Trainings, Open Discussions
and Youth Volunteering Activities

<https://romigsc.eu>



Mednarodna fakulteta
za družbene in poslovne študije
**International School
for Social and Business Studies**
Celje · Slovenia · Europe



**INŠTITUT ZA ROMOLOŠKE ŠTUDIJE
IZOBRAŽEVANJE IN KULTURO**
**INSTITUTE FOR ROMOLOGICAL STUDIES,
EDUCATION AND CULTURE**
MURSKA SOBOTA · SLOVENIA · EUROPE



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



Osservatorio Centro Studi
Informatica Giuridica Taranto
**Centre for Legal Informatics
Studies – Taranto Observatory**

isob

Institut für
sozialwissenschaftliche
Beratung GmbH



**Universitat d'Alacant
Universidad de Alicante**

Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Erasmus+, VK3: Iniciativa për politikë inovative – Përfshirja sociale përmes arsimit, trajnimit dhe rinisë
Numri i projektit: 580228-EPP-1-2016-1-SI-EPPKA3-IP1-SOC-IN
Projektet tre vjeçar: 31 dhjetor 2016–31 dhjetor 2019
Shtetet pjesëmarrëse në projekt: Sllovenia, Gjermania, Spanja, Italia, IRJ e Maqedonisë, Turqia

Mbështetja e Komisionit Evropian për këtë botim nuk nënkupton pajtim edhe me përmbajtjen, e cila pasqyron vetëm mendimet e autorëve. Komisioni nuk është përgjegjës për çfarëdo përdorimi të informacionit që gjendet këtu.



**Trajnime, diskutime të hapura
dhe aktivitete rinore vullnetare**



**Përfshirja e romëve
dhe emigrantëve
nëpër shkolla**



Rreth projektit

- Qëllimi kryesor i këtij projekti është mbështetja për integrim më të mirë në arsim të romëve dhe fëmijëve emigrantë përmes aktiviteteve të ndryshme që nxisin zhvillimin e politikës inovative, dialogu mbi politikat dhe zbatimin e tyre, si dhe shkëmbimi i dijeve në sferat e arsimit, trajnimit dhe rinisë.
- Arsimi (mësues të mirë e shkolla të mira) është element thelbësor për integrim të suksesshëm të romëve dhe fëmijëve emigrantë në shoqëri. Megjithatë diversiteti (multikulturor) përbën një mundësi për t'i bërë shkollat më gjithëpërfshirëse, krijuese dhe me mendje të hapur, pabarazia në arsim është më e lartë në mesin e romëve dhe fëmijëve emigrantë. Për shembull, arritjet arsimore të këtyre grupeve janë në përgjithësi më të varfra, ata kanë më shumë gjasa për të hequr dorë nga arsimi i detyruar, që shpie drejt rreziqeve më të larta të marginalizimit shoqëror, drejt dështimit për t'u integruar dhe tekefundit, drejt varfërisë, e cila ka efekte negative afatgjata në zhvillimin social dhe rritjen ekonomike të vendit mikpritës.
- Nxitet po ashtu edhe angazhimi i të rinjve në vullnetarizëm. Vullnetarizmi luan një rol të rëndësishëm në përfshirjen sociale rinore. Kjo i lejon ata që të angazhohen si qytetarë, si dhe për të fituar përvojë, e cila mund t'i rrisë mundësitë e tyre të punësimit.

Qëllimet e projektit

- Krijimi i mjediseve gjithëpërfshirëse dhe demokratike të mësimnxënies;
- Inkurajimi i pjesëmarrjes rinore, zhvillimi i praktikave të përfshirjes që tejkalojnë kufijtë për të arritur deri te rinia;
- Parandalimi dhe luftimi i çdo formë të diskriminimit dhe segregacionit në arsim;
- Nxijtja e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë ndërmjet njerëzve;
- Rritja e cilësisë së aktiviteteve jo-formale të mësimnxënies, praktikave të punës rinore dhe vullnetarizmit.



Inclusion of Roma and Migrants in Schools
Trainings, Open Discussions
and Youth Volunteering Activities



Veprimet kyçe

Studimi fillestar.

Përmbledhje e gjetjeve nga literatura vendore dhe ndërkombëtare dhe praktikave të mira të përfshirjes së fëmijëve romë dhe emigrantë në mjedisin mësimor. Për ta studiuar këtë temë, nevojiten shqyrtime të gjendjes aktuale në shtetet partnere dhe miratim të praktikave të mira që të përmbushen me sukses të gjitha hapat e tjerë të projektit.

Trajnim për vullnetarët. Zbatimi do të mbështetet nga e-klasa dhe do t'i pajisë studentët e angazhuar në vullnetarizëm, me njohuritë e përgjegjësisë sociale, vullnetarizmit, si dhe me strategjitë për të punuar në një mjedis multikulturor, duke u fokusuar te romët dhe emigrantët.

- Qershor 2017 në Slloveni (trajnimi pilot për vullnetarë);
- Janar 2018 në Slloveni, Spanjë, IRJ e Maqedonisë, Itali;
- Janar 2019 në Slloveni, Spanjë, IRJ e Maqedonisë, Itali.

Aktivitet vullnetarizmi. Theks mjaft i veçantë është vënë tek vullnetarizmi si një nga instrumentet e rëndësishme për të ndihmuar fëmijët emigrantë dhe romë që të përfshihen në shkolla dhe në gjithë shoqërinë. Puna vullnetare përqendrohet kryesisht në dhënie të ndihmës fëmijëve gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë, komunikimit me emigrantë në gjuhën e shteteve të tyre, dhënie të ndihmës për integrimin e fëmijëve migrantë dhe prindërve të tyre në rajon dhe në komunitet.

- Nga shkurti deri në maj 2018, në Slloveni, Spanjë, IRJ të Maqedonisë, Itali;
- Nga shkurti deri në maj 2019, në Slloveni, Spanjë, IRJ të Maqedonisë, Itali.

E-platformë për përfshirjen nëpër shkolla dhe tema ndërkulturore. Mundësitë digjitale të mësimnxënies ofrojnë hapësirë të pakufizuar për hartimin e vetë-organizuar dhe mësimnxënien pjesëmarrëse aktive. Materiale të ndryshme janë në dispozicion, të tilla si materiale interaktive, video, kuize, intervista. E-platforma është hartuar kryesisht për mësuesit dhe vullnetarët; megjithatë e-platforma ka pikësynim edhe grupe të tjera: fëmijë, prindërit e tyre dhe vizitorët tjerë në përgjithësi. E-platforma do të realizohet gjatë vitit të fundit



(2019) të projektit në 8 gjuhë: anglisht, gjermanisht, italisht, maqedonisht, slovenisht, spanjisht, shqip dhe turqisht.

Trajnim për mësuesit. Zbatimi i tij do të mbështetet nga e-klasa moodle dhe ka për qëllim që të sigurojë kompetenca më të mira kulturore për mësuesit që mësojnë nëpër klasat ku ka romë apo emigrantë dhe për t'iu dhënë atyre njohuri mbi strategjitë e përfshirjes së këtyre grupeve në klasë. Trajnimi do të zgjasë 2 ditë dhe do të ndahet në punëtori (kompetencat ndërkulturore, strategjitë për përfshirje, specifikat e përfshirjes së fëmijëve romë dhe emigrantë në arsim ...).

- Qershor 2017 në Slloveni (trajnimi pilot për mësuesit);
- Prill/Maj 2018 në Slloveni, Spanjë, IRJ të Maqedonisë, Itali;
- Prill/Maj 2019 në Slloveni, Spanjë, IRJ të Maqedonisë, Itali.

Seminare vendore për të gjithë aktorët. Temat kryesore të seminareve në fushën e edukimit janë të hapura për diskutim me politikëbërës, përfaqësues nga autoritetet lokale, organizatat vullnetare, drejtorë dhe mësues shkollash të niveleve të ndryshme, rininë dhe studentët vullnetarë, akademikë dhe hulumtues të fushës, etj.

- Seminar pilot vendor: qershor 2017 në Slloveni;
- Prill/Maj 2018 në Slloveni, Spanjë, IRJ të Maqedonisë, Itali, Turqi;
- Prill/Maj 2019 në Slloveni, Spanjë, IRJ të Maqedonisë, Itali, Turqi.

Përhapja dhe konferenca ndërkombëtare. Rezultatet e projektit do të përhapen përgjatë jetëgjatësisë së projektit e tutje. Aktivitetet kryesore të përhapjes janë:

- Në Gjermani (maj 2019) dhe Turqi (qershor 2019) do të organizohen dy seminare: (a) seminar për përfaqësues të organizatave sociale; (b) seminar për drejtorë, përgjegjës shkollash, mësues.
- Anëtarët e konsorciumit do t'i prezantojnë rezultatet dhe aktivitetet në vendet jashtë konsorciumit.
- Konferenca ndërkombëtare do të organizohet në tetor 2019 në Slloveni.

